

PAKTI TERRITORIAL I PUNËSIMIT

Komuna e Vitisë



United
Nations
Development
Programme

Empowered lives.
Resilient nations.

Viti
**GRUPI LOKAL I
VEPRIMIT**

Komuna e Vitisë



Drejtoria e Bujqësisë, Turizmit dhe Zhvillimit Rural (DBTZhR) dhe UNDP, në emër të Grupit të Veprimit Lokal, e fillojnë këtë

THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Vitisë dhe UNDP, në kuadrin e zbatimit të projektit të financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC), "Zhvillimi i Integruar Territorial 2" (InTerDev 2), kanë zhvilluar një Pakt Territorial të Punësimit (PTP), i cili synon të promovojë krijimin dhe formalizimin e punësimit për individë të cenusëshëm në komunën e Vitisë si mjet për të promovuar rritjen dhe valorizimin e territorit. PTP i Komunës së Vitisë promovon 5 veprime të parashikuara për të siguruar mbështetje deri në 1000 qytetarë në Komunë.

Ky intervenim mbështet Komunën e Vitisë për të blerë dymbëdhjetë struktura prej druri (1,8m*2,4m) në formën e kiosqeve. Kiosqet janë vendosur në sheshin e ri *Micheline Calmy-Rey* për të qëndruar gjatë gjithë vitit dhe për të shërbyer si pika shitëse për të gjitha grupet e grave, fermerëve dhe artizanët. Kiosqet administrohen nga Komuna me një tarifë simbolike të qirasë (€ 1/muaj) për grupet e ndryshme të prodhuesve (fokusim në grupet e grave). Për të animuar sheshin (si një mënyrë për të sjellë sa më shumë qytetarë/klientë potencialë për mallrat e prodhuara nga këto grupe) dhe për të mbuluar shpenzimet e mirëmbajtjes për kioskat, 3 deri 4 prej tyre janë marrë me qira sezonale për ofruesit e shërbimeve si bar-kafe dhe ushqim.

Kriteret e përshtatshmërisë

Për t'u kualifikuar, aplikantët duhet:

1. Të jenë të regjistruar si grup formal – OJQ, shoqatë apo ndonjë formë tjetër e organizatave të shoqërisë civile me bazë në komunën e Vitisë (sipas kornizës ligjore të Kosovës);
2. Të kenë Statutin i OJQ-së/Shoqatës;
3. Të kenë vendimin për emërimin e përfaqësuesit të autorizuar;
4. Të kenë dëshmi për aktivitetin tragtar aktual – listën me fushat e aktivitetit aktual;
5. Të kenë listën me anëtarët aktual të OJQ-së/shoqatës, me deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe kopjet e letërnjoftimeve;
6. Të kenë dëshmi bankare për të gjitha transaksionet e vitit 2017;
7. Të kenë raportin e auditimit – nëse ka.

Ju njoftojmë se këto janë kritere kualifikuese. Kjo do të thotë që nëse nuk përputhesh me njërin prej këtyre, do të diskualifikohesh gjatë kontrollit të kualifikimit dhe nuk shqyrtohet më tutje për vlerësim. Nëse keni dyshime për një ose më shumë kritere kualifikuese, ju lutemi konsultoni informacionin e dhënë në dosjen e aplikacionit apo kontaktoni **Zyrtarin Mbeshtetes te Prejektiv InTerDev 2 në Komunën e Vitisë**.

Nëse përzgjidheni, duhet të dorëzohen dokumentet e mëposhtme:

1. Kopja e certifikates Valide te Certifikates Valide të Rexhistrimit të OJQ-se/apo si grup formal në Kosovë;
2. Kopja valide e certifikatës së numrit fiskal;

3. Kopja valide e Certifikatës nga Administrata Tatimore e Kosovës sa i përket statusit të borxhit publik të aplikuesit që vërteton se OJQ-ja /Shoqata nuk ka borxhe dhe nëse ka një borxh publik, ato duhen paguar para se komuna të japë në shfrytëzim;
4. Kopja e statusit të OJQ-së/Shoqatës me listën e aktiviteteve;
5. Kopja e raportit narrativ për vitin paraprak të OJQ-së/Shoqatës, përveq nëse organizata është themeluar këtë vitë.

Prioriteti për këtë Thirrje për Aplikim i jepet:

- **Grupet e grave që prodhojnë produkte tipike vendore, zejtare dhe OJQ-ve/Shoqatave që punojnë me personat me aftësi të kufizuara.**
-

Nëse do të përzgjidhni, do të përfitonit sa më poshtë:

- Ndërtimi i shoqatës (NSh) dhe mbështetja.
- Shërbimet e Këshillimit dhe Zhvillimit të Biznesit (BADS)

Si të merrni Formularin e Aplikimit:

Formularin e Aplikimit mund ta merrni në Zyrën e InTerDev 2 Projektit në Viti ose shkarkoni nga web faqja e komunës <https://kk.rks-gov.net/Viti/>

Nëse ju duhen informata shtesë ose ndihmë për ta plotësuar formularët për të shprehur interesin ju ftojmë të merrni pjesë në mbledhjet informuese që organizohen nga komuna e Vitisë dhe UNDP me datën **28 Mars 2018 nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal – Shtëpia e Kulturës në Viti.**

Formularët origjinal duhet të dorëzohen në kopje fizike tek Zyrtari Mbështetës për Projektin e Komunës të UNDP-së para ose deri me datën **6 Prill 2018 në ora 16:00.**

KUJDES: Ju lutemi mos harroni të merrni dokumentin që vërteton se e keni dorëzuar Formularin e Aplikimit dhe dokumentet shoqëruese në kohën e duhur

JU LUTEMI NA NDIHMONI të promovojmë këtë Thirrje për Aplikime duke informuar njerëz të tjerë që mendoni se mund të kenë interes të aplikojnë për këtë mundësi